

Në bazë të nenit 17 të Vendimit për punën e Këshillit për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit, Këshilli për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit në seancën e mbajtur më datën 1 qershor të vitit 2020, shpall:

KONKURSIN

për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit për vitin 2020

1. Çmimi “13 Nëntori” i qytetit të Shkupit u ndahet **personave fizik dhe juridik** si shenjë mirënjohjeje e Qytetit të Shkupit, për **arritje**, në ekonomi, shkencë, art, kulturë, edukim dhe arsim, mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale, sport dhe kulturë fizike, kulturë teknike, mbrojtje dhe përmirësim i ambientit jetësor dhe natyrës, si dhe në segmente të tjera të jetës, punës dhe krijimit, që përbëjnë **kontribut të veçantë dhe për zhvillimin e Qytetit dhe për përparimin e përgjithshëm e afirmimin** në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë.
2. Çmimi për arritje të rëndësishme në fushat e pikës së mëparshme u ndahet edhe personave fizik dhe juridik **nga shtete të tjera**.
3. **Studentëve dhe nxënësve** Çmimi u ndahet për punë krijuese ose arritje të suksesshme në kontinuitet në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore që përbëjnë një kontribut të veçantë për përparimin dhe afirmimin e Qytetit të Shkupit.
4. Çmimi ndahet për arritje në **periudhën e kaluar prej një viti** (llogaritur deri në përfundimin e konkursit), si dhe për një periudhë më të gjatë që përfshin **përmbylljen e një pune krijuese ose të një kontinuiteti në tërësi**.
5. Për individë, grupe krijuesish, nxënës dhe studentë Çmimi përbëhet nga **diploma dhe shumë në të holla**.
6. Çmimi për persona juridik nga vendi dhe persona juridik nga shtete të tjera përbëhet nga **diploma dhe pllakate**.
7. Të drejtën për propozimin e kandidatëve për Çmimin “13 Nëntori” kanë persona juridik dhe fizik.
8. Çmimi mund t’i ndahet përsëri fituesit të mëparshëm, por jo para afatit prej 10 viteve nga marrja e çmimit të fundit.
9. Propozimi për Çmimin duhet të arsyetohet në mënyrë të hollësishme, kurse për kandidatë individë duhet të ketë edhe biografi.
10. Bashkë me propozimin për ndarjen e Çmimit për vepra të botuara dhe botime të tjera bashkëngjiten edhe (2) ekzemplarë të veprës.
11. Konkursi zgjat deri më 10 shtator 2020.

Parashtruesi duhet të japë emrin - titullin e tij të plotë, adresën dhe numrin e telefonit.

Formulari për konkurrimin për Çmimin “13 Nëntori”, mund të merret në zyrën pritëse të Qytetit të Shkupit ose të gjendet në ueb faqen www.skopje.gov.mk.

Propozimet i dorëzohen në tre kopje Këshillit për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit (Qyteti i Shkupit – Parku i Qytetit, bul. Ilinden numër 82), zyra pritëse.

Informacion në tel. 3297-358 dhe 3297-242.

Numër 27-4244/1

1 qershor, viti 2020

**KËSHILLI PËR NDARJEN E ÇMIMIT
“13 NËNTORI” TË QYTETIT TË SHKUPIT**